



01.Nr.85/10  
Më:29.04.2010

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e IV-të (III-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal**  
**në Vushtri mbajtur më 25.3. 2010**

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:00**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri, përveç Refik Ramaj.  
Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, Xhevahire Izmaku, nënkryetare e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.  
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

**R E N D D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 25.02.2010.**
- 2. Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës për vitin 2009, si dhe Raporti i Drejtorisë për Prokurim Publik për vitin 2009.**
- 3. Shqyrtimi i informatës për të hyrat vetanake të Komunës për muajin shkurt 2010.**
- 4. Shqyrtimi i Draftregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Komunën e Vushtrrisë.**
- 5. Shqyrtimi i Draftregullores për përcaktimin e kritereve të përfituesëve material ndërtimor për ndërtim dhe meremetim të objekteve të banimit.**
- 6. Shqyrtimi i Propozimvendimit për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.**
- 7. Shqyrtimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit për ndarje të bursave për studentë.**
- 8. Shqyrtimi i rekomandimit të KPF-së për rritje të numrit të anëtarëve të këtij komiteti.**

**9. Shqyrtimi i çështjeve nga shkresa dt.25.02.2010, e 14 anëtarëve të KK-së të cilët kanë thirrë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, lidhur me: gjendjen e krijuar në fabriken “Llamkos” në Vushtrri pas privatizimit të dështuar të kësaj fabrike, gjendjen e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim nga organet komunale dhe shkaqeve dhe arsyeve të ndërrimit të emrit të SHMP “Latif Berisha” në Vushtrri.**

**10. Të ndryshme.**

**Veli Karaça**- në emër të Grupit asambleistë të LDK-së paraqiti dy kërkesa, për të cilat kërkoi që të debatohet në seancën e radhës, e që janë: mbrojtja e ambientit dhe përmirësimi i furnizimit të qytetarëve me ujë të pijshëm.

**Melihate Basholli**- lidhur me pikën numër 7 të rendit të ditës, propozoi që Drejtoria e Arsimit të sjellë (propozoi) tre emra në propozimvendimin për formimin e Komisionit për ndarje të bursave për studentë. Këtë kërkesë e arsyetoi duke thënë që kjo çështje është më tepër kompetencë e Drejtorisë së Arsimit, dhe në fund propozoi që drejtori i arsimit pas pauzës gjatë seancës të sjellë tre emra të propozuar nga Drejtoria e Arsimit.

**Bahrije Pllana** - lidhur me pikën numër 7 të rendit të ditës, në emër të Grupit asambleistë të AAK-së kërkoi që paraprakisht drejtori i arsimit t’ua sjellë konkursin, në mënyrë që ta dijnë për çka është shpallur ai konkurs , dhe poashtu propozoi që në komision të marrin pjesë edhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës. Dhe në fund tha që paraprakisht është mirë të dihet cilat janë kuadrat e nevojshëm për Komunën, pra cilët janë kuadrat deficietarë.

***Në vazhdim, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, aprovoi rendin e ditës të propozuar sipas ftesës.***

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 25.02.2010.**

**Qazim Azemi**- tha që mungon një pjesë e fjalisë sime, dhe duhet të jetë kështu: “mungesa e teksteve shkollore për 50 lëndë në shkollat profesionale”.

**Veli Karaça**- lidhur me pikën numër 5 të rendit të ditës tha që mungon kjo pjesë e fjalimit tim: “Grupi asambleistë i LDK-së e mbështet propozimvendimin me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes së projekteve dhe ngritjes së cilësisë së punëve dhe përgjegjësisë së komisionit të pranimit teknik të projekteve”.

**Besim Jashari**- në faqe 3, në pjesën e diskutimit të tij, tha që duhet me qenë kështu: “në seancën e kaluar ka pas një Informatë në të cilën është thënë se kanë qenë mbi 400 biznese që kanë operuar pa leje pune”.

***Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur me 25.2.2010, me vërejtje dhe sugjerime të paraqitura nga këta anëtarë të Kuvendit: Qazim Azemi, Veli Karaça dhe Besim Jashari.***

**2. Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës për vitin 2009, si dhe raporti i Drejtorisë për Prokurim Publik për vitin 2009.**

**Bajram Mulaku**- bëri të ditur se raporti në fjalë ka kaluar edhe në KPF, por në KPF nuk ka qenë fjala hyrëse, dhe në vazhdim sqaroi që fjala hyrëse është një rumbullakësim i shkurtër i tërë asaj që është paraqitur në dy raportet e Drejtorisë së Buxhetit dhe Drejtorisë së Prokurimit, duke përfshirë edhe punën që është bërë në shërbime publike.

**Zeqir Hasani**- lidhur me raportin në fjalë, tha që shumica e mjeteve të mbledhura nga qytetarët apo të hyrat vetanake nuk përputhen në 4 pasqyra financiare, duke sugjeruar për përmirësime, me arsyetimin se standardet ndërkombëtare të kontabilitetit kërkojnë respektimin e parimit të përputhshmërisë së shifrave. Kurse

sa i përket investimeve që janë bërë në Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit 2009, pasi që dha lavdata për angazhimin që është bërë, paraqiti disa vërejtje duke thënë që nëse mbi 10 milionë investime janë bërë në infrastrukturë të rëndë dhe të lehtë, kurse sporti i Vushtrrisë është lënë anash, duke u përkrahur me një shumë simbolike prej 11,200 €, kur dihet çfarë talentësh ka sporti vushtrrias. Në vazhdim tha që ka pasë mundësi të ndërtohen halla sportive, me ç'rast rinia do të frekuentonte në to. Poashtu paraqiti vërejtje lidhur me investimet shumë të vogla në bujqësi, duke thënë që bujqësia është shtylla kryesore për zvogëlimin e papunësisë. Kurse sa i përket dhënies së tenderëve, kërkoi nga Kryetari i Komunës që të bëhet më lokalist, dhe t'i mbron bizneset vendore, pasi që në bazë të pasqyrës së dhënë mbi 60% iu janë dhënë firmave jashtë komunës sonë. Gjithashtu kërkoi që të shikohen kapacitetet e firmës e cila e merr tenderin, pasi që shumica e investimeve që janë bërë nëpër rrugë, po intervenohet përsëri në to dhe në këtë mënyrë po shpenzohen mjetet buxhetore. Dhe në fund sa i përket investimeve në arsim, tha që janë ndërtuar shkolla dhe objekte të ndryshme, por ka pasur raste që gjatë stinës së dimrit nuk janë mbajtur orët mësimore, në mungesë të furnizimit me lëndë djegëse.

**Ismet Gashi**- lidhur me raportin në faqe 2, tha që dy herë përdoret fjalia “pjesa lindore”, kështu që nuk dihet në cilën pjesë do të vazhdojnë punimet.

Prej faqes 12 (nga numri 65-99) deri në faqe 15 janë paraqitur furnizim me gypa, dhe janë shpenzuar rreth 57,780 €, por tha që nuk ka njohuri se a janë të vendosur këta gypa, pasi që ka raste kur gypat qëndrojnë të pavendosur, për qëllimin që janë shpenzuar mjetet.

Faqe 23, numri 197, tha që ka të bëjë me kompleksin “Memoriali i Dëshmorëve”, i cili është përruar dhe paguar, dhe e njëjta vlen edhe për martirët, që nuk është i përfunduar, por mjetet janë paguar. Kurse lidhur me raportin e Drejtorisë së Prokurimit, i cili është i bashkangjitur me raportin financiar kërkoi sqarim, pasi që në faqe 5 thuhet që: rruga “Dëshmorët e Kombit” ka kushtuar 954,227.67 €, kurse në faqe 9, numër 9 te raporti financiar i Kryetarit thuhet se ky projekt ka kushtuar 1,055.000 €, e më vonë te raporti i prokurimit thuhet se ka pasë punë shtesë në vlerë prej 69,955 €. Por, kur të llogariten të gjitha këto, bëjnë 1,024.182 €, që nuk është shuma prej 1,055.000 €. Pra është një diferencë prej 30,817 €. Pastaj faqe 10, te raporti i prokurimit kërkoi sqarim lidhur me shumën prej 5,760 € te shërbimet konsulente mjekësore.

Faqe 11, numri i prokurimit 29, furnizimi me material higjienik në shumën 15,544 €, pyeti se për çfarë materiali higjienik bëhet fjalë, se nëse është për administratën komunale, dihet që ky shërbim është i privatizuar dhe e kryen një kompani private. Përsëri faqe 11, numri i prokurimit 40, për pastrimin dhe larjen e rrugëve të qytetit janë shpenzuar 27,138 €, dhe shtoi se do të ishte shumë i kënaqur nëse ndonjë qytetar i Komunës së Vushtrrisë të ketë qenë i kënaqur të paktën tri ditë me pastrimin e rrugëve në qytet. Faqe 11, numri i prokurimit 50, për furnizim me karburante dhe vaj për automjete, ngrohje dhe gjenerator të administratës komunale janë shpenzuar 94,501 €. Në vazhdim tha që është bërë mirë që janë paraqitur të gjitha shpenzimet bashkarisht, pasi që veturat e Komunës qarkullojnë vikendeve pandërprerë për punë jozyrtare.

Te numri i prokurimit 205, tha që me këtë numër janë 4 prokurime, dhe janë shpenzuar 5,707 € për veshmbathje të dy drejtorive. Por, tha që është mirë që Komuna po shpenzon për punëtorët e vet në veshmbathje, por kërkoi që kjo të mos bëhet në mënyrë diskriminuese, pasi që për punëtorët në fjalë ka edhe beneficione tjera. Në fund tha që raportet që vijnë nga drejtoritë duhet t'i drejtohen Kryetarit dhe Kryetari e formulon dhe e dorëzon për Kuvend, dhe si shembull të mirë sa i përket adresimit të raportit përmendi atë të Drejtorisë për Prokurim.

**Habib Mustafa**- sa i përket raportit tha që në të është paraqitur gjendja sa i përket financimit të Komunës, procedurat e shfrytëzimit të mjeteve financiare, investimet që janë bërë gjatë vitit 2009, gjegjësisht projektet e realizuara. Pastaj tha që esenca e

Drejtorisë për Buxhet është grumbullimi sa më i madh i të hyrave në buxhetin komunal nga të gjitha format e mundshme. Prandaj tha që drejtoria në fjalë ia ka arritur qëllimit, pasi që për vitin 2009 ka pasë një buxhet përfundimtar prej 9,038.366 €, kurse të hyrat vetanake kanë qenë 1,092.875.89 €. Poashtu nga raporti shihet se është bërë menaxhim i mirë i shpenzimeve të këtyre mjeteve, si dhe realizim i projekteve të planifikuara, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në standardin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës sonë. Gjithashtu është pasqyruar në mënyrë tabelare raporti i ekzekutimit të buxhetit, dhe shihet që viti 2009 është ndër vitet me arritshmërinë më të lartë të realizimit të buxhetit, krahasuar me vitet e mëparshme. Në vazhdim duke iu referuar tabelës 4 të raportit të ekzekutimit të buxhetit, tha që pagesat nga granti i përgjithshëm, fondi 10, granti qeveritar është realizuar në 99.45 %, që nënkupton se drejtorinë në fjalë kanë realizuar buxhetin në afat dhe kohë të duhur sipas planifikimit. Në mënyrë më të mirë paraqitet edhe inkasimi, llojet e të hyrave dhe ndarja sipas kodeve ekonomike, dhe në formë të mirë është paraqitur edhe pasqyra për realizimin e projekteve gjatë vitit 2009. Në fund tha që e tërë kjo punë që është bërë tregon angazhimin shumë të madh të këtyre drejtorive dhe të Kryetarit të Komunës.

**Arta Ismajli**- kërkoi informatë me shkrim lidhur me këto pyetje: a është bërë pranimi teknik i rrugës “Dëshmorët e Kombit”? pasi që kur ka shi, në udhëkryqin ku gjendet rrethi, në njërin pjesë është e pamundur të kalojnë këmbësorët, pasi që mbledhet uji në atë pjesë. Gjithashtu tha që Ura afër Kishës nuk është e rregulluar sipas kriterëve që duhet të jenë, pasi që një pjesë e trotuarit të asaj rruge nuk është e lidhur, pra ka një hapësirë rreth 1 metër, në të cilën këmbësorët mund të kenë probleme. Pastaj pyeti se në bazë të cilit vendim iu janë dhënë 69,555 € kompanisë “Jehona” nga Malisheva me datën 01.12.2009? duke pasur parasysh që në këtë datë ka qenë koha e fushatës. Në fund tha që nuk dashur që të shfrytëzohet koha e fushatës, sidomos këto shuma parash që janë dhënë për asfaltimin e disa rrugëve, pasi që ka qenë edhe stina e dimrit, dhe poashtu tha që nuk është dashur të shfrytëzohen paratë e buxhetit të Komunës për fushatë.

**Qazim Azemi**- paraqiti disa vërejtje në pjesën hyrëse të raportit të Kryetarit, faqe numër 2 , tha që kur flitet për monumentet e kulturës sonë, duhet të shtohet për meremetim dhe restaurim edhe Hamami i qytetit, sepse është monumenti i tretë që e kemi. Në faqe numër 3 është përmendur se kush është përgjegjës për vjeljen e të hyrave. Për rritjen e fondeve në Komunën tonë janë përmendur: Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria e Ekonomisë. Pastaj tha që këto drejtori është mirë të na informojnë pse për dy vite (2008-2009) nuk është vjelë asgjë në fondet komunale prej pronave që i ka Komunë jonë, dhe në fund tha që është mirë që edhe Kryetari edhe Kuvendi e kanë për detyrë të dijnë ta mbikëqyrin punën që bëhet në ato drejtori.

**Sabit Kadriu**- tha që në raport ka disa paqartësi gjatë hartimit të tij edhe në aspektin teknik, dhe është mirë që të përmirësohet pasi që mbetet në arkivin e Komunës. Pastaj duke iu referuar paragrafin në raport: “nga të gjitha këto projekte të planifikuara, vetëm një prej tyre nuk është realizuar në vitin 2009”, kërkoi që për hir të transparencës në seancën e ardhshme të potencohet emri i projektit që nuk është realizuar. Mandej paragrafi tjetër ku thuhet: “Vlen të theksohet se hartimi i projektit zhvillimor urban për Komunën paraqet bazë të domosdoshme për hartimin e Planit Rregullativ Urban për qytetin dhe Komunën, në mënyrë që të ndërtojmë një qytet bashkëkohor dhe ruajmë sipërfaqen tokësore të Komunës” , pohoi se kjo bjen në kundërshtim me realitetin, i cili mbretëron në Komunën e Vushtrrisë, pasi nuk e di a disponon Komuna me një projekt urban të qytetit, dhe tha që kjo çka po ndodh është brengosëse, pasi që është një kaos i jashtëzakonshëm urban, prandaj ky kaos duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë . Ndërsa në paragrafin që flitet për monumentet e kulturës, kërkoi sqarime se a është ky projekti turk për meremetimin e monumenteve të kulturës, apo duhet që me buxhetin e Komunës të meremetojmë

monumentet e kulturës dhe të historisë? Kurse sa i përket Kullës së Azem Bejtës, kërkoi që të intervenohet sa më shpejt për meremetimin e saj në Galicë, pasi që është një monument i rëndësishëm për historinë dhe kulturën e popullit tonë. Në vazhdim tha që e ka parë se pranë Urës së Gurit, ku ka qenë një park shumë i mirë, dikush është duke ndërtuar diçka, dhe kërkoi informacione lidhur me këtë ndërtim. Ndërsa, sa i përket ndërtimit të memorialëve, tha që Memoriali i Martirëve ka qenë dashur të vendosej tek Muri i Zahir Pasomës, për rastin e masakrës së 22 majit 1999 në Vushtrri, e jo të vendoset një memorial në një vend ku nuk mund të shihet nga ndërtesat që e mbulojnë, poashtu tha që memoriali në fjalë ka zënë edhe atë hapësirë të vogël gjelbërimi, që ka mundur të shfrytëzohet nga fëmijët.

**Muharrem Shabani**- tha që është obligim ligjor që të jemi transparent para Kuvendit dhe para qytetarëve të Komunës sonë, dhe të paraqesim llogaridhënie për çdo cent që mbledhet nga taksat qytetare. Por, për planet investuese zhvillimore të Komunës ka nevojë të debatohet dhe të shkruhet më gjatë, dhe në mënyrë më analitike dhe më përmbajtësore, pasi që planet investuese nuk mund të përfshihen në raport prej dy faqe e gjysmë, dhe se për shumë çështje nuk flitet sikur për raport, por flitet sikur për plan pune. Në vazhdim tha që pajtohet se përqindja e realizimit është e mirë, por nëse shikohet në esencë se a janë shfrytëzuar këto, apo kanë mundësuar dispozitat e reja ligjore të Ligjit të Prokurimit dhe formave tjera të pagesës me avance, mund ta kuptojmë që një pjesë e madhe e këtyre projekteve nuk është kryer, duke mos hyrë tek çështja e kualitetit, dhe si shembull përmendi rrugën tek rrethi, për të cilën tha që punëkryesi duhet t'i eliminoi ato të meta, sepse uji po flen dhe po paraqet problem për kalimin e udhëtarëve, pasi që një pjesë është e shkëputur nga ura. Kurse sa i përket gypave, tha që qytetarët po pyesin pse iu janë marrë përsëri gypat e plastikës, pasi që janë shpërndarë nëpër shumë fshatra. Sa i përket kursimit, tha që në prokurim ka çalim të planifikimi real i projekteve, pasi që nuk ka projekte reale në krahasim me vlerat reale të një projekti. Gjithashtu tha që do të kërkojmë që në tërësi këto projekte që janë dhënë, a janë realizuar në cilësi dhe a është bërë pranimi i tyre teknik, pasi që koha kur janë shpallur, ka dhënë me dyshuar se mund të realizohen. Në lidhje me prokurimin, tha që nuk e din që Kuvendi ka marrë ndonjëherë vendim me 1 dhjetor, në kohën kur nuk ka funksionuar, për 69,955 € për rrugën "Dëshmorët e Kombit", dhe pyeti a ka ndonjë vendim, pasi që sipas tij nuk ka një vendim të tillë, dhe tha që është e arsyeshme pasi që një pjesë e madhe e tenderëve janë realizuar në kohën e fushatës zgjedhore. Në fund lidhur me numrin rendor 243 të prokurimit, është paraqitur shuma 6,930,15 € për ndërtimin e depos ndihmëse për shkollën fillore në fshatin Vesekoc, duke shtuar se shifra është marramendëse dhe jashtë normales.

**Besim Jashari**- tha që janë për t'u përhëndetur të gjitha projektet investive që janë bërë, dhe e kanë përmirësuar jetën e qytetarëve edhe në qytet edhe në fshatra. Por kërkoi që të bëhet pasqyrim real i gjendjes, në mënyrë që në periudhën e ardhshme t'i shohim ku janë të metat, ku kanë qenë dobësitë, kështu që edhe Ekzekutivi, edhe Kuvendi bashkarisht të shohim se si mund të bëhet përmirësimi edhe në kuptimin e shfrytëzimit të buxhetit, edhe në kuptimin e realizimit të projekteve investive që janë me shumë interes për Komunën. Pastaj tha që në raport janë paraqitur kategoritë ekonomike, ku mëditjet janë realizuar 99 % dhe kjo është pozitive, por kur është fjala për investimet kapitale, shihet se nga investimet që janë bërë në vitin paraprak, është përmirësuar gjendja në shumë aspekte, si në: infrastrukturën rrugore, kanalizim, ujësjellës dhe në shkolla, por hapësirave të lira për këmbësorë shumë pak i kushtohet rëndësi, me përjashtim të zgjerimit të rrugës që është bërë në dalje të qytetit. Në fund tha që në raportet paraprake në shumë raste janë paraqitur informata dhe raporte nga të cilat është kuptuar se Komuna nuk ka realizuar të hyrat e nevojshme, dhe ato që i ka planifikuar, dhe tha që do të ishte mirë që me realizëm të shihet se cilat kanë qenë mundësitë për inkasimin e të hyrave vetanake, pastaj duke e përmendur Informatën në të cilën janë paraqitur mbi 400 biznese që kanë

operuar pa leje, tha që Komuna i ka humb tërë ato të hyra , pasi që nuk i ka inkasuar. Poashtu tha që në raport mungojnë investimet sa i përket përgatitjes së infrastrukturës direkte për investime të jashtme, pasi që nëse nuk ka infrastrukturë direkte e prek direkt investitorin e jashtëm, ai nuk vjen, dhe si ilustrim përmendi rastin kur në vitin 2009 në një seancë është paraqitur investitori me projektpropozimin për ndërtimin e një fabrike të kërpudhave, e pastaj nuk ka pasë asgjë konkrete në këtë drejtim.

**Veli Karaça**- tha që ky raport paraqet vetëm një pjesë të punës së Komunës, kur ka të bëjë me menaxhimin e financave, kurse mungojnë pjesët që flasin për menaxhimin e personelit dhe të pronës. Pastaj tha që fakti se u paraqiten shumë vërejtje, nënkupton se raportit për nga përmbajtja i mungojnë disa pjesë qenësore. Duke e përshëndetur tërë këtë investim dhe sukses të Komunës, tha që raportit i mungojnë dy pjesë qenësore: përfundimet dhe rekomandimet për të ardhmen, pasi që këtu janë paraqitur tabela të mjaftueshme dhe projektet në detaje, mirëpo nëse ka një shqyrtim analitik, atëherë mund të nxirren disa përfundime: a i kanë plotësuar nevojat e qytetarëve këto projekte dhe në cilën masë, a janë kryer me kohë, dhe kostoja, me çfarë cilësie, sa kanë qenë të shpërndara nëpër bashkësi lokale? Pasi që paraqiti vërejtje se një pjesë e madhe e këtyre projekteve është koncentruar në 3-4 bashkësi lokale, prandaj pyeti se sa e kanë përmirësuar cilësinë e jetesës, sa e kanë përmirësuar cilësinë e arsimit, kur janë bërë investime mbi 2,125.822 € vetëm në objekte arsimore, ndërsa janë rezultatet shumë më të dobëta se në vitin 2008, që nuk kanë qenë tërë këto investime. Pastaj pyeti sa është përmirësuar cilësia e shërbimeve shëndetësore? A duhet këto investime në të ardhmen të orientohen në drejtime tjera? Në vazhdim propozoi që sa i përket arsimit, të investohet edhe në njerëz, në ngritjen e kuadrove përmes trajnimeve dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Në fund tha që ka pasur investime të mjaftueshme, por cilësia e kryerjes së punëve ka mundur me qenë më e mirë, dhe pasi që ka pasur mungesë të cilësisë së projekteve, propozoi që të stimulohen organet mbikëqyrëse për pranim teknik.

**Pajazit Pllana** - tha që furnizimi me pajisje mjekësore në QKMF në Vushtrri, dhe me material laboratorik, sipas raportit të Drejtorisë për Prokurim figuron të njëjtat kushte, i njëjti përfitues. Pastaj tha që nuk është servisimi i pajisjes mjekësore, e cila ka rol të rëndësishëm, pasi që të gjithë do të jemi nevojtarë të saj, e ndoshta mjetet kanë shkuar në drejtim tjetër që duhet të analizohen, pasi që në QKMF, në shërbimin emergjent mungojnë: puls oksimetri dhe mjetet themelore të cilat i masin parametrat vital të jetës së njeriut, prandaj tha që Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Prokurimit e kanë për obligim shpenzimet në laborator dhe në këto tjera, ndoshta janë të arsyeshme, por duhet të rivlerësohen. Pastaj paraqiti vërejtje lidhur me gjelbërimin, mbjelljen e fidaneve dhe drunjëve dekorativ, dhe pyeti se kush përkujdeset për to, dhe a jemi të vetëdijshëm për gjithë këto mjete që shkojnë, dhe gjithë ato tharje që bëhen, për çdo vit ipen të holla, kryhen dhe mbeten pa u mbikëqyrur.

**Xhylsime Feka** - tha që raporti është i kurtë, konciz dhe i kuptueshëm. Dhe tha që me rritjen e shumës është i arsyeshëm edhe realizimi i projekteve të mëdha kapitale dhe i projekteve të vogla. Pastaj tha që puna e këtij Kuvendi, e Kryetarit të Komunës dhe stafit menaxhues komunal ka bërë që qytetarët, sidomos në dy vitet e fundit, të mësohen me faktin që premtimet, planifikimet dhe zotimet të kryhen. Poashtu tha që puna dhe serioziteti menaxherial kanë ndikuar në thithjen e granteve dhe donacioneve, në rritjen e të hyrave vetanake dhe bashkë me këtë edhe rritja e intensitetit të punëve, të cilat kryhen edhe gjatë vikendeve. Zhvillimi ekonomik dhe social i Komunës sonë është i bazuar në planet mjaft transparente investuese dhe politikat e hapura dhe transparenca e procedurave të prokurimit, poashtu ajo tha që duhet përkrahur bizneset dhe veprimtaritë e ndryshme ekonomike të qytetit tonë. Në fund lidhur me kaosin urbanistik, tha që këto dy vitet e fundit po bëhen përpjekje

maksimale për dalje nga ky kaos që është krijuar vite më parë, duke shtuar se e mbështetë raportin dhe punën e Kryetarit të Komunës.

**Bajram Mulaku**- duke i falënderuar këshilltarët e Kuvendit të Komunës për sugjerimet dhe vërejtjet, shtoi se ndihet mirë që në Komunën tonë janë realizuar disa projekte që i shërbejnë qytetarëve të Komunës sonë. Pastaj lidhur me vërejtjen për përkujdesin ndaj drunjëve dekorativ, tha se projekti që është shpallur vitin e kaluar, dhe kemi menduar për mirëmbajtjen e tyre, prandaj janë ndarë mjete të caktuara për mirëmbajtje, dhe njoftoi se në vitin e kaluar janë ujitur gjatë tërë stinës së verës ata drunjë dhe pjesa absolute janë në gjendje të mirë. Kurse kompania që e ka fituar projektin e ka për obligim me kontratë që çdo fidane që dështon, me përsëritur dhe bëri të ditur që kompania e cila ka kryer këtë punë ka filluar me ndërrimin e fidaneve të dështuara me fidane të reja. Kurse sa i përket realizimit të projekteve me standarde, tha që gati të gjitha rrugët që janë shtruar në asfalt, nuk kam lejuar pa projekte, dhe është përdorur një metodë që ka kushtuar në shumën e përgjithshme, por ia ka vlejtur. Pastaj tha që metoda ka qenë e tillë që komuniteti me i bërë vet projektet, pasi që kur bëjnë kontrata private me kompanitë që janë të licencuara kushton shumë më lirë, mirëpo kur bashkësitë lokale i kanë marrë për t'i bërë këto projekte, i kanë bërë sipas qejfit të tyre dhe kostoja e realizimit të atyre projekteve na ka kushtuar. Ndërsa sa i përket vërejtjes për rrugën “Dëshmorët e Kombit”, tha që as vet nuk është i kënaqur, pasi që shtesa e fundit nuk është shtruar me standard, prandaj edhe nëse është bërë pranimi teknik, Kryetari i Komunës ka të drejtë dhe e kam formuar komisionin e veçantë për vlerësimin e gjendjes, në mënyrë që të mos i lëshohet 10 % kompanisë, pa i bërë përmirësimet adekuate, dhe njoftoi që nuk është vetëm ky rast, por janë edhe dy apo tri rrugë tjera. Ndërsa lidhur me punën shtesë që është bërë në këtë rrugë, tha që kjo punë shtesë për rrugën në fjalë është bërë për pjesën e rrugës prej fundit të Urës, duke kaluar kah Kisha, e deri te qasja përtej Urës së Hekurit, dhe aty janë 60 metra, pra për këto 60 metra kemi kërkuar punë shtesë, sepse nuk kanë qenë të planifikuara në projektin e parë, pasi që në projektin e parë ka qenë rruga e planifikuar vetëm deri te rrethi, pra deri te kooperativa, kurse Ura është krejt tjetër projekt, prandaj projekti i Urës nuk ka qenë në projektin e rrugës, dhe është dashur të ketë punë shtesë. Sa i përket vërejtjes se a po ia qëllojmë ku po i harxhojmë mjetet, u përgjigj se gjithmonë po mundohet me ndjek punë esenciale që janë në interes të Komunës. Dhe shtoi se nuk ka zhvillim, nuk ka përmirësim të jetës, pa dalë nga balta, prandaj nuk ka prioritet më të madh, se sa realizimi i projekteve të rrugëve. Poashtu ndër prioritetet e mëdha është edhe ndërtimi i hapësirave shkollore, dhe lidhur me këtë tha që premisat themelore në arsim janë dy: krijimi i hapësirave të mjaftueshme për t'u mbajtur mësimi, dhe rritja e pagave të arsimtarëve, dhe shtoi se hapësirat shkollore janë të domosdoshme, pasi që ka pasë raste kur është punuar me nxënës në 5 ndërrime, ndërsa momentalisht të gjitha shkollat punojnë me 3 ndërrime, ndërsa rritja e pagave të arsimtarëve nuk është kompetencë e tij. Në vazhdim njoftoi se ka qenë synimi i tij kryesor bërja e planit urbanistik të Komunës, dhe vitin e kaluar është hartuar plani zhvillimor i Komunës, kurse tani duhet të bëhen planet rregullative pjesë-pjesë, pra 17 pjesë. Ndërsa këtë vit janë paraparë mjetet dhe do të filloi hartimi i planit rregullativ për pjesë të qytetit, dhe sipas atij plani rregullativ do të ndërtohet edhe urbanizmi i qytetit. E lidhur me kaosin urbanistik tha që nuk është fajtor për ngulfatjen e qytetit, duke shtuar se është vështirë të largohen kiosqet, pasi që prej tyre e nxjerrin idaren. Sa i përket vërejtjes për mosrealizimin për fabrikën e kërpudhave, u përgjigj se nuk është realizuar ky projekt, pasi që është tërhequr kompania e cila ka qenë e interesuar. Kurse për thithjen e investimeve të jashtme, tha që po mundohemi me shfrytëzuar çdo mundësi për hartimin e projekteve. Sa i përket hapësirave për lëvizje të lirë të këmbësorëve, bëri të ditur se së shpejti do të fillon ndërtimi i një trotuari me standarde, duke filluar nga gjimnazi, prej parkut e deri te rruga “Ismail Qemajli”, dhe poashtu njoftoi se është i interesuar për ta larguar trafon nga gjimnazi,

pasi që paraqet rrezik të madh për nxënësit. Kurse lidhur me vërejtjen që tenderët të shpallen në kohë të përshtatshme, tha që është mirë që sa më shumë të nënshkruhen projekte edhe në kohë fushate për interesa të qytetarëve, kurse sa i përket realizimit të tyre, përmendi si shembull rrugën në fshatrat Beqiq-Duboc, duke thënë se është nënshkruar dhe ka filluar të realizohet, por pasi që nuk ka mundur të kryhet gjatë stinës së dimrit, do të kryhet tani. Ndërsa lidhur me vërejtjen që nuk është bërë planifikimi real, u përgjigj se gjithçka po planifikojmë së bashku, përndryshe projekti për rrugën Stroc-Bequm nuk është realizuar në tërësi, kurse projektet tjera të planifikuara nga Komuna, apo Qeveria e Kosovës të vitit 2008, për vitin 2009 janë realizuar. Sa i përket fabrikës së ujit, tha që 5 milionë euro janë siguruar dhe tenderin e shpallë Ministria e Financave, por janë duke punuar në kompletimin e dokumentacionit dhe në një të ardhme të afërt do të shpallet tenderi. Kurse sa i përket lokacionit për ndërtimin e fabrikës së ujit, njoftoi se pas një bashkëpunimi me ekspertë nga Mitrovica dhe Prishtina, është vendosur që fabrika e ujit të ndërtohet nën kanalin e Ibër-Lepencit, me lartësi mbidetare prej 550 metrave, poashtu do të ndërtohet një bazen prej 10.000 metra kub, që do t'i ketë dy pjesë, njëra pjesë do të shfrytëzohet, kurse pjesa tjetër do të mbetet rezervë. Në vazhdim tha që është i interesuar për shfrytëzim racional të mjeteve, dhe stimulim të kompanive vendore, por tha fatkeqësisht nuk kemi asnjë kompani të mirëfilltë vendore në Komunën tonë, që shtrajnë asfalt. Pastaj tha që nëse kompanitë tona fitojnë ndonjë projekt për të shtruar asfalt, duhet patjetër të bashkëpunojnë me dikënd, edhe ato kompani tona që kanë fituar projektin me të tjera kompani kanë dështuar, dhe njëra kompani është futur në listë të zezë, dhe nuk do të marr projekt në të ardhmen nga Komuna, pasi që nuk e ka kryer punën siç duhet. Gjithashtu tha që obligimet ligjore për transparencë po mundohet me i plotësuar, prandaj i keni tri raporte: nga Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria e Buxhetit dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Mandej tha që monumentet e kulturës ka qenë i angazhuar për të bërë ruajtjen më të madhe të tyre, në vazhdim njoftoi se ka filluar restaurimi i Kalasë me një projekt të Ministrisë së Kulturës, do të vazhdoi edhe me mjete tjera për këtë vit, dhe pastaj në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve do ta bëjmë edhe restaurimin e Kalasë, e jo vetëm hulumtimet arkeologjike. Ndërsa lidhur me Hamamin e qytetit, bëri të ditur se Ministria e Kulturës ka premtuar se do ta harton projektin, pasi që kur ta kemi projektin, mund të shfrytëzohet mundësia për të kërkuar donacione, pasi që nuk mundet dhe nuk është kompetencë e Komunës me bërë projektin, por është kompetencë e Ministrisë së Kulturës, mirëpo do të angazhohemi që këtë vit me pasë projektin për restaurimin e Hamamit, por gjithashtu nevojitet që së pari të heqet tregu, në mënyrë që t'i lëshohet fryma Hamamit dhe Komunës. Pastaj tha që te Ura e Gurit është një projekt që ka filluar para një viti dhe gjithçka ka qenë transparente, është shpallur tenderi, është vendimi i Kuvendit, dhe është dhënë leja. Në vazhdim tha që aty po ndërtohet një restorant i vogël nga druri, i cili ka për obligim sipas kontratës t'ia paguan Komunës mbi 200 € në muaj, dhe do ta ndërton një park për të gjithë qytetarët, dhe kurrë më nuk ka me qenë deponi e mbeturinave. Pastaj tha që duhet shfrytëzuar Ligjin e koncesioneve publiko-private, dhe kapitalistëve duhet me iu dhënë hapësirë për të punuar, sipas interesave të Komunës. Dhe në fund njoftoi se në këtë vit është projekti për pastrimin dhe gjelbërimin e hapësirës mes dy bankinave, duke e bërë stazën prej 600 metrave dyanësore, dhe do ta shtrojmë në zhavorr, sa për të lëvizur dhe shëtitur qytetarët e Komunës sonë.

**Besim Jashari**- tha që nën Urën e Hekurit gjendet një urë jashtë çdo logjike profesionale, prandaj aty u dashtë me u marrë masa dhe mos me u lejuar, sepse tani do të kushton për ta korrigjuar, dhe pastaj propozoi që të bëhet një urë harkore. Gjithashtu e përmendi edhe çështjen e projektit për ndërtimin e fabrikës së kërpudhave, dhe tha se fakti që një investitor i jashtëm ka ardhur dhe ka hulumtuar terrenin në disa Komuna (ndër to edhe në Vushtrri), kjo nënkupton që na ka bërë një vlerësim, dhe kur investitori ka ardhur në Kuvend të Komunës dhe ka bërë



prezantimin e projektit, është hap pozitiv që jemi në rrugë të mbarë, por dështimi në këtë rast është dështim i autoriteteve, dhe tha se për t'i shërbyer transparencës, është dashtë të informohet Kuvendi për arsyet e dështimit të projektit në fjalë.

**Bajram Mulaku**- tha që Ura te shtrati i lumit "Tërstena" nuk ka qenë projekt i kompanisë, por edhe kjo urë ka qenë në mesin e 15 urave si donacion i Qeverisë. Pastaj tha që kompania që e ka ndërtuar atë urë nuk është konsultuar fare me mua, dhe as me kompaninë e përparme "Rukolli", dhe shtoi se është tepër keq e ndërtuar, por do të bëj përpjekje për ta hequr krejt, ose për ta gjetur një zgjidhje tjetër.

**Fadil Muzaqi**- tha që është realitet që bizneset vendore duhet të përkrahen, mirëpo në kushte të barabarta do të përkrahen çdoherë. Kurse sa i përket dallimeve, Ligji i Prokurimit nuk njeh biznese lokale, vendore apo ndërkombëtare. Poashtu njoftoi që është duke u përgatitur forma elektronike e prokurimit, kështu që në të ardhmen do të kenë mundësi edhe prej shteteve të rajonit të marrin pjesë në ofertim. Ndërsa sa i përket rrugës "Dëshmorët e Kombit", tha që është e vërtetë që shuma e këtij projekti nuk është 1,050.000 € duke u bazuar edhe në vlerën e punës shtesë, por është bërë një gabim pasi që Kryetari i Komunës ka mundësi që është bazuar në marrëveshjen çfare ka qenë me Ministrinë e Transportit rreth bashkëfinancimit të këtij projekti. Pra vlera reale është 1,020.000 €, kurse vlera e kontratës bazë është 954,000 €, dhe vlera e punëve shtesë është 69,995 €. Ndërsa sa i përket vlerës së punëve shtesë, tha që këto punë nuk janë të paparapara, por janë punë shtesë të cilat me rastin e ndërtimit të urës ka lindur që të lidhet rruga "Dëshmorët e Kombit", kështu që ka qenë pjesë e asfaltimit dhe e kubëzimit me trotuar. Gjithashtu gjatë ekzekutimit të këtij projekti, një pjesë e një lagjeje nuk ka hyrë në projektin bazë, dhe është dashtë afro 300 metra të ndërtohet ujësjellës (linjë e re e kanalizimit), dhe nuk janë punë të paparapara, por janë punë të reja. Kurse këto mjete për ëunë shtesë janë siguruar një pjesë nga buxheti i Kuvendit komunal, ndërsa pjesa tjetër (rreth 50,000 €) janë financuar nga Ministria e Transportit. Ndërsa lidhur me disa shërbime konsulente, theksoi që shërbimet konsulente janë ndier nevojë e QKMF-së, që në kuadrin e saj ata t'i lëshojnë disa certifikata për patent shofer, ndërsa QKMF-ja nuk posedon kuadër të atij rangu, dhe ato paguhen, pra ajo është një e hyrë për QKMF-në pasi që doktorët e marrin një provizion për shërbimet e kryera konsulente, kurse të tjerat i mbesin QKMF-së. Sa i përket furnizimit me material higjienik, tha që është i destinuar për njësitë tjera shpenzuese, siç janë: shkollat, shëndetësia, por nuk është i destinuar për njësinë shpenzuese (autoritetin kontraktues) të administratës komunale. Kurse pastrimi dhe larja e rrugëve është proceduar dhe është udhëhequr tender, fituese e tenderit ka qenë "Uniteti" njësia Vushtrri. Ndërsa lidhur me vërejtjen pse furnizimi me karburante nuk është i ndarë, bëri të ditur se nuk ndahet, për arsye se furnizimi bëhet për të gjitha njësitë shpenzuese dhe për hir të racionalizimit dhe shfrytëzimit sa më të mirë të mjeteve, kurse në tender ka qenë e precizuar dhe thuhet furnizim me karburante për: automjete, gjenerator dhe ngrohje qendrore. Dhe në fund sa i përket veshmbathjes, tha që është proceduar një tender dhe ata që kanë pasë mjete të planifikuara për veshmbathje i kanë realizuar sipas parashikimit të tyre.

**Dibran Përçuku**- tha që pajtohet me disa vërejtje të paraqitura nga ana e këshilltarëve të Kuvendit, kur kërkohet cilësi e projekteve, kurse sa i përket Memorialit të Martirëve, tha që nuk ka përfunduar akoma, pasi që familjarët akoma nuk i kanë sjellur në detaje regjistrat e të rënëve të tyre. Ndërsa sa i përket kërkesës për ndarje e derivateve për automjete nga shpenzimet tjera, bëri të ditur se Drejtoria e Shërbimeve Publike gjithmonë i ndanë dhe i përcjellë shpenzimet e derivateve. Kurse lidhur me shfrytëzimin e automjeteve zyrtare të Komunës edhe gjatë vikendeve, tha që kjo ndodh pasi që duhet të bëhet përcjellja e projekteve, pastaj inspekcioni punon edhe vikendeve, por edhe mbikëqyrësit e rrugëve. Pastaj tha që në këtë raport kemi paraqitur një pasqyrim në detaje, se sa projekte janë, cilat janë atë projekte, ku janë realizuar, sa ka qenë gjatësia e tyre, cila kompani i ka kryer, në

cilin vit janë realizuar dhe kush ka participuar. Kurse sa i përket furnizimit me gypa, tha që është marrë një vendim në Kuvend për t'u ndarë një shumë për furnizim me gypa të kanalizimit për qytetarët, poashtu bëri të ditur që ka pasë shumë kërkesa dhe është bërë ndarja ashtu siç ka qenë e nevojshme, por ka disa lagje që në bazë të kërkesave të tyre i kemi furnizuar me gypa, por nëse nuk i ngjeshin edhe dy muaj, gypat do t'iu merren dhe do t'i shpërndajmë në lagje tjera. Lidhur me projektet që nuk janë realizuar deri në fund, tha që kanë qenë projekte 2-vjeçare, gjithashtu njoftoi se janë edhe tri rrugë që kanë qenë të kontraktuara vitin e kaluar, por për shkak të kushteve atmosferike nuk kanë mundur të kryhen, por do të kryhen sivjet. Sa i përket gjelbërimit, tha që kemi mbjellë drunjë dekorativ dhe bari, dhe gjelbërimin e ka mirëmbajtur ajo kompani që e ka marrë, e cila e ka pasë kontratën për 6 muaj. Dhe në fund njoftoi se është planifikuar edhe sivjet që prokurimi ta shpallë tenderin për 634 drunjë dekorativ në 56 lokacione, duke i përfshirë edhe shkollat dhe ambulancat, dhe marrëveshja e obligon që ta mirëmbanë edhe gjelbërimin e vitit të kaluar.

**Ismet Gashi**- tha që e kam potencuar që automjetet zyrtare të Komunës gjatë vikendeve përdoren përveç për nevoja zyrtare, edhe për çështje private, pasi që shihen duke u bartur fëmijë dhe gra me automjetet në fjalë. Nërsa sa i përket lagjes së tij, tha që për atë lagje nuk janë sjellë gypa asnjëherë dhe se kanalizimi është në gjendje të mjerueshme.

**Besim Jashari**- duke u ndërlidhur me atë që e tha D.Përçuku lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare edhe gjatë vikendit, tha që Udhëzimi Administrativ mbi përdorimin e automjeteve zyrtare në Komuna, vetëm Kryetarit të Komunës ia njeh të drejtën e përdorimit 24 orë të automjetit zyrtar, prandaj pyeti nëse ka ndonjë akt tjetër me të cilin është rregulluar kjo çështje.

**Qerim Selimi**- tha që është në pyetje një shkollë, pasi që ka 2 vite që mbajmë mësim në lokale private, dhe ato lokale nuk plotësojnë asnjë kusht dhe paguajmë qira prej 500 € në vit. Pasi që si emër të shkollës nuk do të kalonte në projekte, e kemi paraqitur si objekt ndihmës, dhe ka dimension prej 612 metrave, dhe përfshinë: një klasë të madhe, një klasë të vogël dhe nyjet sanitare.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 22 vota "për", të tjerët "abstenim" aprovoi raportin në fjalë.**

### **3. Shqyrtimi i informatës për të hyrat vetanake të Komunës për muajin shkurt 2010.**

**Isuf Jashari**- paraqiti sqarimet hyrëse.

**Zeqir Hasani**- sugjeroi Drejtorisë së Buxhetit të bëhet vetëkritike, pasi që këtu janë paraqitur vetëm dy pozicione ku ka tejkalime alarmante të të hyrave, pra bëhet fjalë për tatimin në pronë dhe taksën komunale, mirëpo tha që nuk paraqiten edhe pozicionet tjera të të hyrave, ku inkasimi është shumë i dobët, dhe njëkohësisht të kërkohej arsye dhe shkaqe pse ndodh ajo, pastaj të merren masa. Pastaj tha që sipas pasqyrës të hyrat vetanake për muajin shkurt 2010 shihet në bazë tabelare se janë nën plan, si dhe më të vogla se një vit më parë. Në vazhdim kërkoi sqarim rreth pozicionit të të hyrave nga regjistrimi i automjeteve, pasi që në këtë Informatë dikun shënon të hyrat nga regjistrimi i automjeteve, e dikun të hyrat nga taksat rrugore, dhe pyeti se a ka të drejtë Komuna si institucion të mbledhë taksa rrugore, kur dihet se qytetari taksat rrugore i paguan në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pastaj tha që nëse në muajin shkurt të vitit 2009 të hyrat nga taksat kanë qenë 15,458 €, nuk ka mundësi që për këtë pozicion të planifikohet mbledhja e të hyrave më e vogël se që ka qenë në vitin paraprak. Dhe në fund kërkoi disa informata: mbi obligimet e painkasuara të taksës komunale për vitin e kaluar; mbi obligimet e painkasuara të tatimit në pronë për vitin e kaluar; mbi numrin e ekonomive familjare të ngarkuara me tatim në pronë; për numrin e bizneseve aktive dhe joaktive.

**Isuf Jashari**- duke iu referuar vërejtjes që paraqiti këshilltari se pse janë paraqitur vetëm këto dy pozicione të të hyrave në mënyrë tabelare, u përgjigj se në faqe numër 5 janë të gjitha kategoritë e të hyrave, dhe është planifikimi dhe realizimi nga të gjitha drejtoritë.

#### **4. Shqyrtimi i Draftregullores për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Komunën e Vushtrrisë.**

**Ahmet Shuku**- (në emër të drejtorit të urbanizimit) paraqiti sqarimet hyrëse.

**Sami Istrefi**- tha që rregullorja në fjalë do t'i trajtoi me vëmendje ndërtimet që janë bërë deri me tani në Komunën tonë. Pastaj tha që kemi kërkuar që të ndryshohet neni 11, pasi që nëse shkohet me kriterin që përmban ky nen, pala që duhet të pajiset me dokumentacion për t'i dorëzuar në drejtorinë gjegjëse, prapë palës do t'i vështirësohet puna, sepse ai do t'i dorëzon tri kopje të projektit, dhe për t'i bërë tri kopje të projektit kushton, prandaj propozoi që kjo rregullore të shikohet me vëmendje, pasi që do të paraqitet edhe në diskutim publik, por njëkohësisht kërkoi që t'iu paraqitet të gjitha bashkësive lokale, pasi që ka një karakteristikë të veçantë, ku janë edhe masat ndëshkuese tek neni 17.

**Ismet Gashi**- tha që do të ishte më mirë që kjo draftregullore para se të vjen në Kuvend për shqyrtim, të kalon nëpër komisione, apo organe tjera profesionale në mënyrë që delegatët të mos merremi me çështje formale, pasi që është e bazuar në dispozitat që nuk ka të bëjë fare me këtë lëmi që trajtohet. Në vazhdim lidhur me hyrjen e draftregullores, neni 16.1, b,c,d, të Ligjit për Planifikim Hapësinor, tha nuk e trajton ky nen këtë lëmi fare, dhe neni 16.1 i Ligjit për Planifikim Hapësinor s'ka b,c,d hiq, por trajtohet çështja e hartimit të planeve hapësinore. Pastaj tha se neni 23 i Ligjit për Ndërtimin ka të bëjë me revizionin e projektit, që për disa projekte të mëdha ka nevojë të bëhet revizioni i tyre, e jo me trajtim të ndërtimeve pa leje. Neni 37.2, a,b, tha që nuk e trajton fare Statuti i Komunës këtë çështje, por e trajton funksionimin e Komitetit për Komunitete. Pastaj neni 2, paragrafi "ndërtimet pa leje" thirret në Ligjin 2004/37, kurse Ligji mbi Ndërtimin është 2004/15.

Neni 6 dhe 7, dy herë është e shënuar "regjistrimi i ndërtimeve pa leje", prandaj tha mund të jetë gabim teknik, por që duhet të mjeket sepse thelbi është krejt diçka tjetër. Pastaj në nenin 8, në pjesën e fundit duhet të jetë "pas shpalljes publike të regjistrimit të ndërtimeve pa leje", e jo "të shpalljes së konkursit". Lidhur me nenin 11, tha që është dashtë ekspertët e urbanizimit të na sqarojnë këtë, pasi që nuk ka nevojë të bëhet për objekt që është ndërtuar edhe statika se cila kompani do ta merrte përsipër t'ia bëjë statikën një objekti, por projekt gjithsesi, pasi që diçka duhet të ketë për t'u lëshuar leja ndërtimore. Dhe në fund lidhur me nenin 17.2 i cili thotë "taksa nga paragrafi 17.1 nën a,b,c do të paguhet 1 vit pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje", kërkoi sqarim, pasi që nuk e ka kuptuar.

**Bajram Mulaku**- tha që duhet të bëhet dallimi në mes të dhënies së lejes për ndërtim dhe legalizimit për ndërtim. Pastaj tha që ndërtimet që janë bërë nuk mund të rrëzohen, por mund të legalizohen, dhe nuk mund të jepet tash leje, pasi që veç është bërë ndërtimi. Poashtu tha që nëse dëshirojmë të nxjerrim të holla, duhet bërë legalizim, pasi që deri më tani vetëm pse janë kërkuar leje, nuk është bërë legalizimi, sepse leja kushton nga 3,000 – 7,000 €. Në fund kërkoi që neni 11 jo të thirret në ligj, por të gjendet një formë adekuate në mënyrë që të bëhet legalizimi qysh duhet.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Draftregullorja në fjalë ipet në diskutim publik konform rregullave ligjore në fuqi.***

## **5. Shqyrtimi i Draftregullores për përcaktimin e kritereve të përfituesëve material ndërtimor për ndërtim dhe meremetim të objekteve të banimit.**

**Safet Idrizi**- paraqiti sqarimet hyrëse.

**Sabit Kadriu**- tha që kjo rregullore ka shumë gabime gjuhësore, dhe kërkoi që të përmirësohen dhe propozoi që materiali të kalon përmes lektorit. Pastaj lidhur me nenin 2.5, tha që ky kriter nuk është i arsyeshëm, pasi që do të paraqiten shumë familje që do të kenë konflikte mes vete, vetëm sa për të realizuar interesin e vet material. Mandej lidhur me kriteret për përzgjedhje në nenin 3, tha që nëse është burri, ose dikush nga femrat e vrarë gjatë luftës, më nuk kryesohet familja nga ata, por ka qenë e krye-suar, pra në mungesë të kujdestarit të familjes. Në fund sa i përket nenit 6, tha që në vend të termit “ankim”, duhet shënuar “ankimim”, dhe kërkoi që neni 6.2 të përpilohet në atë mënyrë që të jetë më i kuptueshëm. Kurse te dispozita kalimtare, tha që “hyrja në fuqi” nuk ka nevojë të shkruhet si një paragraf i veçantë.

**Xhylsime Feka**- paraqiti vërejtje tek neni 3.1, duke thënë që është formulim i gabueshëm, dhe propozoi që të shënohet: “familje e kryesuar nga gratë, nënat vet-ushqyese”. Dhe në fund tha që nga neni 3.3 nënkuptohet se kanë të drejtë me aplikuar të gjithë ata kanë më shumë se tre fëmijë.

**Safet Idrizi**- duke iu referuar vërejtjeve të paraqitura nga S.Kadriu, tha që me rëndësi është përmbajtja substanciale. Dhe tha që jemi të vetëdijshëm që me këtë rregullore nuk zgjidhet problemi i strehimit, por qëllimi ka qenë që të jemi sa më të hapur dhe të drejtë në përcaktimin e kritereve për ndarje të materialit ndërtimor.

**Pajazit Pllana**- propozoi që të thuhet “personat me nevoja të veçanta”, në vend të “personat me aftësi të kufizuara”. Pastaj lidhur me nenin 4.4, pyeti se cila shkallë e komisionit e përcakton invaliditetin, dhe kush është kompetent me dhënë vlerësimin profesional, pasi që invaliditeti është çështje komplekse që kërkon kohë dhe procedurë, dhe procedura është shumë e komplikuar, duke pasur parasysh se komisionet që funksionojnë në kuadër të Republikës së Kosovës për personat me aftësi të veçanta, për komisione të vlerësimit janë të pakta, prandaj propozoi që Drejtoria e Shëndetësisë së bashku me Kryetarin e Komunës për këtë punë ta autorizojnë një ekip të ekspertëve, nëse pajtohet Kuvendi që ta shkurtoi procedurën.

**Safet Idrizi**- sa i përket shkallës së invaliditetit, tha që pavarësisht a është invalid i luftës, invalid civil apo invalid i punës, e cakton komisioni i caktuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe për neve është valide nëse ata e kanë dokumentacionin përkatës, pra shkallën e dëmtimit trupor, dhe në fund tha që nuk mund ta caktojmë shkallën e invaliditetit në nivelin komunal.

**Idriz Muzaqi**- tha që pasi që është një projekt i ndërlikuar, dhe nuk mjafton 1 muaj për identifikimin e rasteve, poashtu më tepër se 1 muaj do t'i merr procedura e tenderimit për shpërndarjen e materialit, prandaj kërkoi që draftregullorja në fjalë të aprovo het në këtë seancë, pasi që edhe vënia në diskutim publik do të merr aq shumë kohë, sa që do t'i afrohem sezonës së dimrit, me ç'rast shpërndarja e materialit do ta humbë kuptimin e vet.

**Ferit Idrizi**- tha që derisa draftregullorja t'i nënshtrohet diskutimit publik, komisioni mundet me dalë në terren dhe me i identifikuar të gjitha rastet në bazë të kërkesave të parashtruara, pasi që edhe ashtu kjo rregullore nuk është për t'i identifikuar rastet, por është për përcaktimin e kritereve për shpërndarje të materialit ndërtimor.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Draftregullorja në fjalë ipet në diskutim publik konform rregullave ligjore në fuqi.***

## **6. Shqyrtimi i Propozimvendimit për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**

**Idriz Muzaqi**- paraqiti sqarimet hyrëse.

**Ismet Gashi**- tha që këtë rregullore e kemi aprovuar me 30.12.2008, ka hyrë në fuqi në vitin 2009, pastaj në 2009 janë bërë 2 apo 3 ndryshime, në 2010 janë bërë 2 ndryshime, pra po bëhet lojë me qytetarët, pasi që draftrregulloren për tarifa dhe ngarkesa e kemi qit në diskutim publik, kurse në prapaskenë (pas shpinës së qytetarëve) bëjmë ndryshime me propozimvendime, dhe ato nuk shkojnë fare në diskutim publik. Në vazhdim paraqiti vërejtjet lidhur me propozimvendimin, duke thënë që në hyrje thirret në nenin 31, paragrafi 2, pika a,g dhe n, kurse tha që pika “n” nuk e rregullon fare këtë çështje të Statutit të Komunës, dhe duhet të hiqet. Gjithashtu paraqiti vërejtje për formën e vendimit. Pastaj tha që neni 2, thotë “paragrafi 1.19 i nenit 3 hiqet nga rregullorja”, por tha që në seancën e kaluar kemi aprovuar edhe një vendim që ia kemi shtuar edhe paragrafin 1.20, dhe pyeti se si do të jetë rregullorja që do të inkorporohet ky propozimvendim, nëse aprovohet. Në vazhdim tha tek “arsyetimi” thotë: “lirimi nga taksa administrative sipas nenit 3.2, nën (a)”, por tha që të gjitha janë vullnet i palës, pasi që pala vet përcaktohet a vjen për të kërkuar shërbime në Komunë, mirëpo janë të nevojshme, në dispozitiv nuk e ka cek, por në arsyetim është thirrur në nenin 1.14, mirëpo tha që neni 1.14 nuk ka të bëjë, pasi që rregullon krejt diçka tjetër. Në fund tha që vet propozuesi ka thënë që vërtetimi identik të zbritet prej 2 € në 50 cent, kurse tash atyre që ua kemi njoftë atë të drejtë, familjeve të dëshmorëve, skamnorëve, të hjekën prej kësaj.

**Idriz Muzaqi**- pajtohem me vërejtjen e këshilltarit të Kuvendit se tek “arsyetimi” në vend të paragrafit 1.14, duhet të jetë 1.10. Pastaj tha që nëse mendoni që vërtetimi i një certifikate, pasi që ta merr pala te ofiqari duhet të kushton më shtrenjtë kopja që të vërtetohet, se sa certifikata, atëherë le të mbetet kështu siç është, por është një lëshim shumë i madh, sepse shërbimi për vërtetim të kopjes së dokumentit është më pak i kushtueshëm për Komunën, se sa lëshimi i certifikatës. Poashtu tha që nuk ka kurrfarë arsye që qytetari për ndërrim të emrit personal të lirohet prej takse, pasi që kjo nuk ndodhë askund, sikurse nuk guxon të ndodhë që qytetari i cili bën kurorë në ndonjë hotel apo restorant, të shkon ofiqari pa kurrfarë shpenzimi të lidhë kurorë.

**Ismet Gashi**- tha që nuk e kundërshtova ndërrimin prej 2 € në 50 cent, por formën qysh është përgatit është shumë konfuze, dhe në këtë formë nuk iu ka hije ta votojnë delegatët e Kuvendit, nëse nuk ndryshohet.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, një “kundër” të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Aprovohet propozimvendimi për plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa gjje Gjjoba komunale, në bazë të vërejtjeve të paraqitura.***

## **7. Shqyrtimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit për ndarje të bursave për studentë.**

**Qerim Selimi**- paraqiti sqarimet hyrëse.

**Vlora Qirezi**- tha që për konkursin e shpallur më 23.09.2009 është formuar një komision, kurse tani po formohet komision tjetër, dhe propozoi që së pari të shfuqizohet ai vendim. Dhe në fund tha që grupi asambleistë i LDK-së do të marrë pjesë me një anëtar, nëse komisioni në fjalë ka në përbërjen e tij anëtarë të Kuvendit.

**Qazim Azemi**- sa i përket kategorisë së dytë, tha që pajtohet, kurse sa i përket kategorisë së parë 20 bura, propozoi që nëse është e mundur të bëhet korrigjim i konkursit, pasi që kanë mbetur disa profile (profesione) që janë shumë të nevojshme për Komunën tonë, dhe njëkohësisht propozoi që të shtohen disa profile, duke e zbritur numrin e bursave në disa profile që janë caktuar, dhe të caktohen 1 ose 2 bursa për bujqësi, pastaj për ekonomi dhe biznes, teknologji informative. Kurse propozoi që të zbritet numri i bursave te gjeodezia, te seksioni muzikor, te seksioni i

gjuhës angleze (prej 4, të mbeten 3), te Fakulteti i Mjekësisë (prej 5, të mbeten 4), dhe të shtohen propozimet që i paraqita.

**Ferit Idrizi**- tha që studentët i kanë pritur shumë gjatë këto bursa, e nëse tani i plotësojmë edhe me profile tjera, duhet me rishpallë konkursin, prandaj propozoi që të mbeten profilet e propozuar për herat tjera. Dhe në fund propozoi që në përbërje të komisionit në fjalë të jenë prej grupeve asambleiste nga një përfaqësues (PDK, AAK, LDK) dhe dy përfaqësues të jenë nga Drejtoria e Arsimit.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

**Anëtarët e komisionit për ndarje të bursave caktohen: Vlora Qirezi, Qazim Azemi, Selim Rrustemi, anëtarë të KK-së, Qerim Selimi, Drejtor i DKA-së dhe Murteza Dallku, zyrtar i DKA-së.**

**8. Shqyrtimi i rekomandimit të KPF-së për rritje të numrit të anëtarëve të këtij komiteti.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Kjo çështje do të vëhet sërish në rend dite të mbledhjes së KK-së, pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit të Komunës.***

**9. Shqyrtimi i çështjeve nga shkresa dt.25.02.2010, e 14 anëtarëve të KK-së të cilët kanë thirrë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, lidhur me; gjendjen e krijuar në fabriken “Llamkos” në Vushtri pas privatizimit të dështuar të kësaj fabrike, gjendjen e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim nga organet komunale dhe shkaqeve dhe arsyeve të ndërrimit të emrit të SHMP “Latif Berisha” në Vushtri.**

**Qazim Azemi**- tha që është pozitive që kanë hyrë në rend dite për debatim kërkesat e grupeve opozitare. Sa i përket ndërrimit të emrit të shkollës, tha që përveç që ka shkaktuar një indinjatë të thellë, ky ndërrim ka kaluar pa vendim, as nga drejtori e shkollës përkatëse, as nga DKA-ja, që nënkuptohet se nuk është i ligjshëm. Pastaj tha që për këtë ndërrim ka munguar debati me profesorët, familjarët dhe intelektualët, pra ka munguar transparenca. As DKA-ja nuk i ka propozuar tre emra për riemërim, por janë bazuar në propozimin e para 5 vjetëve, kur DKA-ja e atëherëshme kishte propozuar dhe ishte përcaktuar për Latif Berishën, me ç'rast edhe e mori emrin “Latif Berisha”. Mandej tha që është manipuluar me kërkesat e dy shkollave, njëra në Smrekonicë me emrin legjitim “Enver Hadri”, tjetra në fshatin Dobërlukë. Në vazhdim tha që me emrin e poetit Latif Berisha emërohet shkolla në Dobërlukë, e jo në Smrekonicë, ku është vendlindja e poetit. Poashtu tha që ka bërë një pyetje se si ka shkuar procedura? Por tha që ka marrë një jo të plotë dhe jotransparente nga DKA-ja. Tha që është një përgjigje jo e plotë, e panënshkruar dhe është me dorëshkrim të një kërkesë të një shkolle me datën 09.09.2009, dhe tha se të gjitha këto kërkesa janë bërë me këtë datë, gjithashtu është edhe letërbështetja për emërimin e shkollës fillore në Smrekonicë, dhe këtu aludohet kinse për familjarët e Latif Berishës, e që është e paverifikuar, pa nënshkrim, pra nuk është e plotë.

Mirëpo, tha që ka dalur se familja Berisha nuk është pajtuar me atë ndërrim për poetin. Në faqe 3 e kemi një kërkesë të drejtorit të shkollës në fjalë, e cila është aq abuzuese dhe e pavend, pasi që në fillim kërkon shqyrtimin e mundësisë për ndërrimin e emërtimit të shkollës, pra ai ka kërkuar, por nuk është bërë askund. Në vazhdim tha që del kontradiktore pasi që edhe tash bazohet në një propozim të mëhershëm, të para 5 viteve, bazohet në një propozim të një shkolle tjetër (njëherë të shkruar me dorë, e pastaj me shkrim), pastaj bazohet në atë se kinse vendlindja e profesorit është Smrekonica, e jo Dobërluka. Mandej tha që bartja e emrit të poetit për propozim të sërishëm në një shkollë tjetër është bërë pa ndonjë vendim konform me ligjin, por vetëm sipas ndonjë propozimi të paverifikuar. Drejtoria e Arsimit në

referencën 10, nr.383/09 kërkesa për referimin e shkollës së mesme "Latif Berisha", tha se u shkel procedura, u shkel ligji, sepse nuk i ka dërguar tre emra, që kërkohet me atë rregullore, por ka shkuar vetëm emri i martirit Bahri Haxha, pra këtu mund të shihet se vendimi i ministrisë nuk përputhet me propozimin e Drejtorisë së Arsimit, pasi që MASHT-i në arsyetimin e vendimit thotë: "Komisioni konstatoi se lënda ka kaluar nëpër procedurë të rregullt, këshilli i shkollës ka propozuar tre emra", dhe tha që nuk janë askund këta tre emra, duke shtuar se këshilli i shkollës nuk ka marrë askund vendim, pastaj thuhet "duke i dhënë prioritet emrit të dëshmorit Bahri Haxha". Pastaj tha që në këto dokumenta e pamë që kanë shkruar se janë propozuar tre emra nga këshilli i shkollës, por tha që nuk kanë qenë të propozuar nga këshilli i shkollës, por janë dërguar vetëm me disa propozime, me disa vendime që e kanë vetëm datën, që herë përputhen, e herë nuk përputhen. Pastaj pyeti se kush ishte Latif Berisha? Për t'u përgjigjur se Latif Berisha është edukatori, profesori, mësuesi, profesori universitar, poeti i ëmbël që në vitet më të vështira të kohës së Rankoviçit ka ndikuar bashkë me shumë të tjerë që të mos shpërngulen mbi 400.000 shqiptarë. Latif Berisha është ai që u dashtë me u shtuar emrat e shkollave, e jo me u hjek, Latif Berisha është ai që edhe më vonë në lëvizjen demokratike bëri punë të çmuara, duke punuar për popullin e vet, punoi për kombin e tij, duke u bërë hero i demokracisë dhe i kulturës që e ruajnë sot gjeneratat që e kanë njohur dhe universiteti, prandaj propozoi që ky vendim i ngu tshëm të rishqyrtohet, dhe të mos bëhet modë ndërrimi i emrave të shkollave, institucioneve, pasi që të gjithë janë të mirë, edhe Latif Berisha, edhe dëshmorët, edhe martirët.

**Ferit Idrizi**- tha që vajza e Latif Berishës është pajtuar, dhe është inicuar, pasi që kur është pavarësuar shkolla, ajo de jure është në Dobërllukë, de facto është në Smrekonicë, dhe në atë shkollë Latif Berisha e ka kryer shkollën fillore dhe thuhet që e ka shkruar poezinë e parë. Pastaj tha që askush, as Drejtoria e Arsimit nuk është e interesuar me i vë në lojë emrat e atyre që kanë dhënë jetën, dhe e kemi obligim për t'i respektuar familjet e tyre dhe të përulemi para eshtrave të tyre. Në fund tha që më vonë ka ardhur fjala e vajzës së Latif Berishës që ajo nuk e paska ditur dhe paska menduar që emri i babait të saj do të mbetet edhe në shkollën e mesme në Vushtrri, dhe njëkohësisht do të bartet në Smrekonicë.

**Muharrem Shabani**- tha që askush nuk mund t'i përvetëson disa vlera, askush nuk mund t'i fiton disa tituj me privilegje apo me favore në shoqëri. Por kishte me qenë mirë që në formë transparente të bisedohet para ndërmarrjes së këtij akti dhe vendimi të caktuar, sepse të gjithë janë qytetarë të këtij vendi, qoftë martirë, qoftë dëshmorë, apo hero, dhe është obligim i yni që ato gjëra t'i respektojmë, e jo t'i ndajmë dhe t'i nënçmojmë. Pastaj tha që nëse kjo Komunë ka edhe tri shkolla tjera pa emra, pyeti pse atëherë të preket atje ku është kryer, është emërtuar. Pastaj tha që familja e Latif Berishës ka menduar që mund të emërohen dy shkolla me emrin e tij. Në vazhdim tha që është irrituese kur atë ditë të ceremonisë është gjuajtur me armë në prezencë të nxënësve. Mandej tha që nëse Kuvendi është organi më i lartë në Komunë, është dashtë të informohet për këtë ndryshim dhe emërim të ri të shkollës, e jo të kuptohet përmes krismave dhe formave të ndryshme. Mandej tha që mbledhja me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit nuk është më dispozicion i Kryesuesit të Kuvendit, por është vendim i grupit të caktuar i cili ka të drejtë së bashku me Kryetarin e Komunës me thirrë mbledhjen e Kuvendit. Gjithashtu tha që nuk pajtohet me gjendjen e punëtorëve të Llamkosit, kurse sot e morëm një informatë prej Llamkosit, por nuk dihet kush e ka hartuar, sepse nuk shkruan asnjë emër. Poashtu tha se e din që edhe Kryetari i Komunës i ka pranuar në takim, por kemi dashtë një fuqizim më të madh, duke dalë me një qëndrim nga Kuvendi me të cilin organet kompetente qendrore të vendit apo ndërkombëtare ta marrin seriozisht dhe të veprojnë sipas kërkesës tonë, në mënyrë që Llamkosi të mos shkatërrohet sikur shumë firma tjera. Ndërsa, lidhur me çështjen e pronave, tha që Kuvendi në përbërjen e kaluar ka marrë një mori vendimesh për tjetërsimin e pronave, për

dhënie me qira të ndryshme (afatgjate dhe afatshkurta), prandaj dëshirojmë të dijmë lidhur me të gjitha ato vendime, në vazhdim duke pyetur për rastin e kërpudhave, tha që sot po e dijmë që qenka tërhequr, poashtu pyeti se çka u bë me rastin e lumit te Graca? çka u bë me atë ndërtimin te Pestova? çka po bëhet te Ura e Gurit, cili është interesi i Komunës? çka është bërë me vendimin që është marr për një pjesë te Holiday? Pastaj çështja e Shtëpisë së Kulturës. Prandaj tha që kërkon që të nxjerren këto shënime prej regjistrimit se cilat vendime janë dhënë, dhe sa hektarë, pasi që kemi marrë vendime për qindra hektarë. Pra është e nevojshme të na jepet mendimi me shkrim, pasi që deri më tani vetëm për një çështje është dhënë, për tjerat nëse nuk ka vendime, nuk është shpallë, vetëm një kontratë. Në fund tha që nuk ka nevojë çështjet me i lënë të mbyllura, nuk ka paragjykim, por ka një qëllim që vërtetë të kemi një transparencë të plotë për të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Komunës.

**Sabit Kadriu-** tha që ashtu siç ka ndodhur me emrin e Azem Bejtës në Kërpime, që u bë atentat ndaj Azem Bejtës, atentati i dytë ndodhi me Latif Berishën pas vekjes, i cilia ka qenë një veprimtar i denjë i kauzës kombëtare. Poashtu tha që gjatës bisedës me familjen e Latif Berishës, tha që familja e tij nuk është dakorduar me iu hjek emri shkollës, mirëpo edhe në këtë rast të gjitha materialet që janë këtu, askund nuk përputhen datat, e nëse shikohet libri i protokollit do të del krejt diçka tjetër. Në vazhdim tha që drejtori i shkollës në Smrekonicë ka bërë një kërkesë të pa nënshkruar, pastaj tha që Ministri i Arsimit e ka marrë vendimin, ashti siç iu është komentuar atij, dhe shtoi se është i bindur se ai nuk e ka hartuar këtë vendim, sepse ai që e din do ta hartonte dhe do të thoshte: “emrin të cilin shkolla e ka pasë deri tash ‘Latif Berisha’ shfuqizohet vendimi, dhe kjo shkollë emërtohet kështu, ndërsa shkollës tjetër i jepet kështu”. Në fund tha që është turp ta vëjmë në diskutim emrin e Latif Berishës në 11-vjetorin e vrasjes së tij.

**Qerim Selimi-** tha që akuzat në drejtim të Drejtorisë së Arsimit janë të pabaza. Pastaj tha që ky emërim i shkollës është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ, dhe në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ shënon shumë mirë procedura e emërimit të shkollave, në vazhdim përmendi nenet 3,4,5, dhe 6, me të cilat është e rregulluar procedura e emërimit dhe riemërimit të një shkolle. Kurse sa i përket çështjes së falsifikimit të dokumentacionit, tha që kërkesa e drejtoreshës së shkollës është shkruar me dorë, sepse është shkollë e re, pastaj kësaj kërkesë iu ka bashkangjitur kërkesa tjetër nga familjarët, e cila e tillë më ka ardhur në drejtori dhe është protokolluar, poashtu tha që nuk është e vërtetë që nëse shikohen këto data të protokollit, mund të del diçka tjetër. Mandej tha që vajza e Latif Berishës e ka pranuar që ka bërë kërkesë, por pasi që është kërkuar seancë e jashtëzakonshme, është tërhequr vajza e L.Berishës, ndërsa punëtori i shkollës i cili e ka pranuar kërkesën e vajzës së Latif Berishës ka sjellë deklaratë me shkrim. Gjithashtu njoftoi se në ministri i kemi paraqitur tri propozime për shkollën e Dobërllukës, dhe janë këto: Latif Berisha, Gjergj Fishta dhe 17 shkurti, kurse tri propozimet që janë dërguar në Ministrinë e Arsimit për shkollën e mesme profesionale janë: Bahri Haxha, 7 marsi dhe 17 shkurti, pra janë arsyetime me shkrim që gjenden në Ministrinë e Arsimit. Poashtu tha që në bazë të vendimit për emërimin dhe riemërimin e shkollës, palët e pakënaqura kanë afat 30 ditë të bëjnë ankesë, kurse deri më tani asnjë ankesë nuk është paraqitur as në DKA, as në drejtori të shkollës, prandaj tha që nuk po e kupton se cilat janë arsyet e reagimit të qytetarëve. Gjithashtu njoftoi se janë edhe 6 shkolla tjera që janë të paemëruara, pasi që janë shkolla që rishtas janë themeluar, dhe ato presin një emërim, por procedura e emërimit do të zbatohet në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ. Në fund tha që është respektuar kërkesa e familjes Berisha, dhe drejtoresha e shkollës e ka ftuar edhe familjen Beri sha në inaugurimin e shkollës, por familja nuk ka ardhur, poashtu tha që nëse është ky emër politikisht, anëtarët e LDK-së dhe AAK-së kanë qenë në këshillin organizativ të inaugurimit të shkollës.



**Sami Istrefi-** lidhur me kërkesën e opozitës për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme me tri pika të rendit të ditës, tha që ato pika të rendit të ditës nuk kanë të bëjnë fare me mbledhje të jashtëzakonshme, pasi që dihet se për çfarë çështjesh thirret mbledhja e jashtëzakonshme, pasi që nëse e shohim ndërimin e emrit të shkollës, atëherë e dijmë që ajo shkollë ekziston me vite, dhe emri “Latif Berisha” iu ka vendosur në vitin 2005 apo 2006. Pastaj tha që gabim i madh është pasi që edhe nëse të gjithë gabojnë, por Ministria e Arsimit nuk gabon në vendimet që i merr. Në vazhdim lidhur me atë që u përmenden pronat, tha se pajtohet që edhe qytetarët tjerë të dijnë për fatin e pronave shoqërore të Komunës, bile edhe për shumë vite, se sa që nga paslufta. Mandej tha që e ka një regjistër prej Kryetarit të kaluar me numër 01, numër 426/06, me datë 03.07.2006, ku i njëjti iu ka drejtuar gjykatës, që ka informuar mbi dëmtimin e buxhetit nga viti 2001 deri në vitin 2006, dhe kjo shumë totale është 738,263 €, duke thënë që këtu nuk ka gjykata, nuk ka institucione gjyqësore, sepse është mëkat që edhe qytetarët tjerë apo shoqëria civile nëse nuk e kanë këtë fakt, dhe të merren këto taksa të qytetarëve për shkak të shkëlqeve ligjore të cilat janë bërë nga udhëheqja e kaluar është turp. Dhe në fund tha që na si delegatë është mirë të ngrisin këto çështje me të cilat buxheti, paraja e qytetarit është dëmtuar, e jo të ngriten disa çështje që na si delegatë i kemi të rregulluara shumë mirë, edhe mbi qasjen në dokumentet zyrtare, edhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

**Muharrem Shabani-** duke iu referuar parafolësit, tha që ka kërkuar dhe insistuar që të gjitha këto të spastrohen, dhe s’ka abolim për askënd. Pastaj tha që disa kanë qenë çështje të vendimeve që janë anuluar, disa janë kryer në faza të caktuara, sidomos për çështjen e tregut kam kërkuar vërtetë të shikohet, por edhe për çështjet tjera që u ngritën, tha që le të hapen, le të dërgohen dhe të adresohen atje ku e kanë vendin, pasi që i kam adresuar edhe vet, jo vetëm te prokuroria, por i kam adresuar atëherë edhe tek organet e UNMIK-ut, që vërtetë të kërkohej një mbrojtje e buxhetit të Komunës. Ndërsa sa i përket pronave, unë kam kërkuar prej organeve këto që po i kërkoj edhe sot, dhe do t’i kërkoj të gjitha, edhe ato më herët, edhe ato më vonë, pra le të dihet, duke mos paragjykuar se çka është çështja, e çka është interes i Komunës, prandaj dëshiroj që këto çështje të spastrohen. Dhe tha që dëshiron të kemi një transparencë të mirëfilltë rreth punës më herët, më vonë, pasi që nuk ka asnjë çështje të mbyllur. Në fund tha se hiqja, vendosja e një emri të dëshmorit nuk është punë e një referenti (drejtori), por është çështje pak më e madhe, është çështje që me pasë një sens për ato kategori të njerëzve që vërtetë ato vlera t’i mësojmë dhe t’i ruajmë gjeneratë pas gjenerate.

**Esat Beka-** tha që nuk ka nevojë që të përjetohet kjo çështje kaq emocionalisht, pasi që kërkesa ka ardhur, drejtori i drejtorisë e ka bashkangjitur në material, kërkesa ka ardhur prej familjes, dhe prej shkollës ku profesori Latif Berisha e ka kryer shkollën fillore, dhe kërkesa nga shkolla e mesme, tash “Bahri Haxha”, që pasi ajo shkollë kërkon me marr emrin e Latif Berishës është bërë në mënyrë krejt ligjore, duke pyetur në fund pse po merr kjo çështje po merr kaq shumë kahje politike?

**Besim Jashari-** duke e çmuar faktin që Kryesuesi i Kuvendit e ka marrë parasysh kërkesën e 14 këshilltarëve për të diskutuar për këtë çështje në Kuvend, tha që nëse ndërimi i emrit të shkollës është bërë sipas të gjitha procedurave, nuk ka asnjë problem, por problemi qëndron në atë se ka munguar transparenca, dhe kjo ka krijuar mundësi për spekulime. Pastaj tha se pasi që ka shkolla të reja në Komunën e Vushtrrisë (5 apo 6 shkolla), ndoshta ka qenë mirë që të vendoset emri që tash u vendos në njërin prej këtyre shkollave, duke pasur parasysh që në shkollën profesionale nuk e kemi pasë emrin e një personaliteti që ka qenë i dyshimtë, por ka qenë një figurë e pakontestueshme në të gjitha aspektet. Në vazhdim njoftoi se iu është drejtuar më herët me një shkresë elektronike Drejtorisë së Arsimit, në mënyrë që të informohet me shkrim mbi arsyen dhe bazën mbi të cilën është ndërruar emri i

shkollës së mesme profesionale “Latif Berisha” në Vushtrri. Pastaj tha që vazhdimisht e ka munduar fakti pse askush nuk shqetësohet dhe nuk po ngutet, duke i lënë 5 apo 6 shkolla në Komunën e Vushtrrisë për të funksionuar pa emër, pa mbishkrim. Pastaj njoftoi që edhe për këtë çështje iu është drejtuar autoriteteve më të larta të Komunës, me kërkesën për ndërmarrje të masave për vendosjen e mbishkrimit para qendrës për punë sociale (objekti i ri), si dhe shkollave të reja në Komunën e Vushtrrisë, të cilat edhe pas disa muajsh të hapjes së tyre, nuk kanë mbishkrim me emrin që e mbajnë, duke shtuar se mungesa e mbishkrimeve nëpër institucione shtetërore publike i vë në lajthitje qytetarët dhe ua vështirëson gjetjen e tyre për nevojat që mund t’i kenë, dhe për më tepër mungesa e mbishkrimeve paraqet shembull të keq për qytetarët, lidhur me respektimin e ligjit nga ana e autoriteteve, të cilave iu është besuar pushteti. Pastaj tha që në Komunën tonë i kemi 5 shkolla që funksionojnë, e njëra shkollë përballë kooperativës tërë vitin e kaluar shkollor pa emër, duke theksuar se të gjitha këto shkolla funksionojnë në mënyrë ilegale, të kundërligjshme. Dhe në fund tha që mungesa e emrit të shkollës paraqet telashe lidhur me dëftesat, shkrimet, adresimi, prandaj shkollës duhet ngjitur emri para se të hapet.

**Qerim Selimi-** duke iu referuar fjalës së këshilltarit B.Jashari, tha që nuk pajtohet me termin “ilegal”, pasi që asnjë shkollë, edhe pse nuk janë të emëruara, janë të themeluara dhe secila prej tyre e ka vendimin e pavarësimit dhe të themelimit. Në fund njoftoi se shumë shpejt do t’i emërojmë të gjitha shkollat.

**Ferit Idrizi-** njoftoi se e ka marrë një shkresë të nënshkruar prej 14 delegatëve, dhe në atë shkresë delegatët kanë thirrë mbledhje, por ajo nuk ka qenë kërkesë e adresuar Kryesuesit të Kuvendit, mirëpo ata e kanë thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme me tri pika të rendit të ditës, dhe aty ka qenë një kundërhënie në mes të Statutit të Komunës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sepse një nen i Statutit thotë që mbledhjen e jashtëzakonshme mund ta thërrasin qereku i delegatëve, e qereku është e 4 hise e delegatëve. Pastaj duke iu referuar nenit 44, pika 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ku thuhet: “Mund të thirret me kërkesën e 1/3, apo të Kryetarit të Komunës të bërë me shkrim”. Mandej njoftoi se sipas konsultave që i ka bërë me ekspertët juridikë, tha që as Kryetari i Komunës nuk ka të drejtë të thirrë mbledhje të jashtëzakonshme, por duhet me i bërë kërkesë me shkrim Kryesuesit të Kuvendit. Pra kjo kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme nuk është anashkaluar për asgjë tjetër, vetëm që nuk është thirrë në ligj. Dhe në fund tha që për respekt ndaj kërkesës suaj, i kam futur këto pika në rend dite për t’i debatuar, dhe u debatuan gjerë e gjatë të gjitha.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:55.**

**Procesmbajtësi:**  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**